



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 mars 2026
Nr. ref.: RK3006/26

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS

në

rastin nr. KO68/26

Parashtrues

Albulena Haxhiu dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
“procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës”**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Albulena Haxhiu, Arbërie Nagavci, Vigan Qorrolli, Adnan Rustemi, Arsim Ademi, Artan Abrashi, Blerim Gashi, Taulant Kelmendi, Mefail Bajqinovci dhe Bylbyl Sokoli, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm:

Kuvendi), të cilët i përfaqëson Albulena Haxhiu, deputete dhe Kryetare e Kuvendit (në tekstin mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e “*procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.*”

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së “*procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*” për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “*deputetët e opozitës, me mos pjesëmarrje në seancën e jashtëzakonshme dhe votim për zgjedhjen e Presidentit të mbajtur me 5 mars 2026 kanë shkelur Kushtetutën dhe janë në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara nga Aktgjykimi i lartpërmendur [KO124/25]*”.
4. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme, “*ndaj procedurës dhe afateve kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, pasi ekziston rreziku i dëmeve të pariparueshme për demokracinë dhe stabilitetin institucional në Kosovë. Kalimi i afateve mund të çojë në shpërndarjen e Kuvendit dhe mbajtjen e zgjedhjeve të treta brenda 18 muajve duke shkaktuar kosto buxhetore, pasiguri politike, pengim të reformave dhe pasoja të drejtpërdrejta për qytetarët e Kosovës, andaj vendosja e masës së përkohshme arsyetohet plotësisht në këtë rast*”.

Baza juridike

5. Kërkesa është parashtruar bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 5 mars 2026, parashtruesit e kërkesës përmes postës elektronike dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të cilën kjo e fundit e regjistroi më 6 mars 2026.
7. Më 6 mars 2026, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KO68/26] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO68/26] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Në të njëjtën ditë, Gjykata i njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) parashtruesit e kërkesës, me ç’rast kërkoi nga Kryetarja e Kuvendit që një kopje e kërkesës t’u dorëzohet të gjithë deputetëve; (ii) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja), e

cila u njoftua edhe për mundësinë e dhënies së komenteve; (iii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri), i cili u njoftua edhe për mundësinë e dhënies së komenteve; dhe (iv) Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit (në tekstin e mëtejme: Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit), të cilit iu kërkua që të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me objektin e çështjes së kontestuar. Afati për dorëzimin e komenteve dhe dokumenteve relevante të Kuvendit, u caktua më së largu deri më 9 mars 2026.

9. Më 9 mars 2026, gjyqtari Radomir Laban kërkoi përjashtimin e tij nga vendimarrja lidhur me kërkesën KO68/26. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, refuzoi kërkesën për përjashtim të gjyqtarit Radomir Laban.
10. Në të njëjtën ditë, Kryeministri dhe deputeti Përparim Gruda nga Partia Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK) dorëzuan komente lidhur me kërkesën KO68/26.
11. Më 11 mars 2026, Gjykata, për komentet e pranuar nga Kryeministri dhe përfaqësuesi i PDK-së i njoftoi (i) parashtruesit e kërkesës; (ii) Kryeministrin; dhe (iii) Presidenten.
12. Më 18 mars 2026, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë, Përgjigje në komentet e pranuar lidhur me kërkesën KO68/26.
13. Më 24 mars 2026, Gjykata pasi shqyrtoi Raportin e gjyqtarit raportues, vendosi që shqyrtimin e tij ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
14. Më 30 mars 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës hedhjen poshtë të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 28 dhjetor 2025, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
16. Si rezultat i certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 11 shkurt 2026, u mbajt Seanca Konstituive e Kuvendit, me ç'rast përmes zgjedhjes së Kryetares së Kuvendit dhe nënkryetarëve, Legjislatura e X-të e Kuvendit u shpall e konstituuar. Po të njëjtën ditë, Kuvendi bazuar në përcaktimet kushtetuese, përkatësisht nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës vijoi me zgjedhjen e Qeverisë.
17. Më 5 mars 2026, Kuvendi, bazuar në kërkesën e dyzet e dy (42) deputetëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mbajti seancën e jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës *“Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës”*.
18. Nga procesverbali i seancës së jashtëzakonshme, të 5 marsit 2026, rezulton se u propozuan dy (2) kandidatë për President të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca dhe Fatmire Mullhaxha – Kollçaku.
19. Kryetarja e Kuvendit konstatoi se në sallë ishin prezent gjashtëdhjetë e gjashtë (66) deputetë. Rrjedhimisht si rezultat i mungesës së prezencës së 2/3 të deputetëve, Kryetarja e Kuvendit ndërpreu seancën e jashtëzakonshme.

20. Më 6 mars 2026, Presidentja, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 dhe paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës nxori Dekretin [nr. 24/26] përmes së cilit theksohet: “1. Shpërndahet Legjislatura e Dhjetë (X) të Kuvendit të Republikës së Kosovës.”

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

21. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e “*procedurës për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*” dhe kërkojnë “*vendosjen e masës së përkohshme për të pezulluar afatet kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit*”.
22. Fillimisht, parashtruesit e kërkesës përkritazi me pranueshmërinë e kërkesës pretendojnë se: “*vendimi për mbylljen e seancës së jashtëzakonshme për zgjedhjen e Presidentit, pa u realizuar votimi i kandidatëve për President dhe si pasojë mos realizimi i afateve për zgjedhjen e Presidentit, ka të bëjë me çështje të rëndësishme kushtetuese që kërkojnë qartësim për të shmangur bllokimin e funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës*”. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës i referohen rasteve të Gjykatës duke theksuar se: “*Në paralelen e njëjtë edhe çështja e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, është çështja e natyrës kushtetuese e cila duhet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese*.” (shih, rastet e Gjykatës [KO124/25](#), parashtrues Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së “*Vendimit të datës 5 maj 2025 për mosvotimin e formimit të Komisionit për Votim të Fshehtë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës*”, Aktgjykim i 26 qershorit 2025, paragrafi 86; dhe [KO193/25](#), parashtrues Memli Krasniqi dhe 12 (dymbëdhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe [KO196/25](#), parashtrues Hykmete Bajrami dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “*Vendimit të Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimit të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025*”, Aktgjykim i 7 gushtit 2025, paragrafi 90).
23. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se veprimet e një grupi të deputetëve, të cilët nuk kanë marrë pjesë në seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të 5 marsit 2026, janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe detyrimet e tjera ligjore duke theksuar se: “*Këtë konstatim e bazojmë në faktin se 54 deputetë nuk kanë marrë pjesë, me qëllim për të pamundësuar kuorumin prej 80 deputetëve të nevojshëm në dy raundet e para të zgjedhjes së Presidentit*.”
24. Tutje, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “*Mospjesëmarrja e qëllimshme, bllokimi i kuorumit apo refuzimi për të kontribuar në procedurat e parapara me Kushtetutë, siç është votimi i kandidatëve për President, nuk mund të konsiderohen si ushtrim i lirë i mandatit të një deputeti, por si shmangie nga detyrimet kushtetuese që rrjedhin nga vetë natyra e funksionit të deputetit*.”
25. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës duke cituar nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, pretendojnë se: “*Pengimi i funksionimit të institucioneve, përfshirë moszgjedhja e Presidentit, i cenon këto të drejta dhe krijon rrezik për funksionimin demokratik të shtetit për të garantuar këto të drejta, veçanërisht duke marrë parasysh detyrimin e lartpërmendur të Presidentit për funksionimin demokratik të institucioneve*.”
26. Tutje, parashtruesit e kërkesës i referohen paragrafit 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] dhe theksojnë se ky nen “[...] kërkon që zgjedhja të behet jo më vonë se 30 ditë para

përfundimit të mandatit, andaj kjo është një obligim procedural kushtetues dhe deputetët e caktuar nuk mund të pengojnë këtë procedurë përmes sabotimeve të qëllimshme që shkaktojnë duke refuzuar të marrin pjesë në seancën e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit.”

27. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se neni 82 [Shpërndarja e Kuvendit] i Kushtetutës përcakton në mënyrë të qartë se kur shpërndahet Kuvendi dhe theksojnë se paragrafi 3 i këtij neni, përkatësisht “[...] moszgjedhja e Presidentit brenda 60 ditëve nga fillimi i procedurës, duhet të nënkuptohet si rast kur shumica e thjeshtë parlamentare nuk mund të zgjedh Presidentin, në linjë edhe në mënyrën e zgjedhjes së përcaktuar në Nenin 86 që është me së paku 61 deputetë në raundin e tretë.”
28. Më tej, parashtruesit e kërkesës i referohen rasteve të Gjykatës KO124/25 dhe KO119/14 dhe pretendojnë se: “Në të njëjtën vijë me pengimin e seancës konstituive të Kuvendit, të cilën pakica parlamentare e kishte bllokuar më herët, edhe pengimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit përbën një praktikë të papranueshme dhe thellësisht jodemokratike.” (shih, rastet e Gjykatës [KO124/25](#), cituar më lart; dhe [KO119/14](#), parashtrues Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014”, Aktgjykim i 21 gushtit 2014).
29. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se paragrafi 2 i nenit 22 (Përgjegjësitë e deputetit) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës përcakton se deputetët janë të obliguar të marrin pjesë në punimet e Kuvendit dhe theksojnë se mospjesëmarrja e deputetëve në seancën e jashtëzakonshme dhe në votimin për zgjedhjen e Presidentit është në kundërshtim me Kushtetutën dhe detyrat dhe me Aktgjykimin e Gjykatës KO29/11. (shih, rastin e Gjykatës [KO29/11](#), parashtrues Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011”, Aktgjykim i 28 marsit 2011).
30. Tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “Në Aktvendimin tjetër KO47/16, Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se prania e 120 deputetëve nuk është kusht për vlefshmërinë e zgjedhjes së Presidentit, mirëpo në fokus e ka pasur vetëm kuorumin prej 80 dhe 61 deputetësh, sipas raundeve të votimit, për të cilin e ka konstatuar se është i domosdoshëm.” (shih, rastin e Gjykatës [KO47/16](#), parashtrues Aida Derguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit nr. 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës”, Aktgjykim i 21 marsit 2016).
31. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: “[...] vendosjen e masës së përkohshme ndaj procedurës dhe afateve kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, pasi ekziston rreziku i dëmeve të pariparueshme për demokracinë dhe stabilitetin institucional në Kosovë. Kalimi i afateve kushtetuese mund të çojë në shpërndarjen e Kuvendit dhe mbajtjen e zgjedhjeve të treta brenda rreth 18 muajve, duke shkaktuar kosto buxhetore, pasiguri politike, pengim të reformave dhe pasoja të tjera të drejtpërdrejta për qytetarët e Kosovës, andaj vendosja e masës së përkohshme arsyetohet plotësisht në këtë rast.”
32. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që:

- “(1) Të shpallë kërkesën të pranueshme.
 (2) Të caktojë masë të përkohshme që pezullon afatin për zgjedhjen e Presidentit deri në nxjerrjen e Aktgjykimit.
 (3) Të konstatojë shkeljen kushtetuese të deputetëve që nuk kanë marrë pjesë, në seancë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.
 (4) Të konstatojë detyrimin e deputetëve për të marrë pjesë në votimin për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës, qoftë pro, kundër apo abstenim dhe të mos pengojnë krijimin e kuorumit të nevojshëm në raundin e parë dhe të dytë të votimit, si dhe masat/sanksionet përkatëse në rast se ndodh një gjë e tillë.
 (5) Të përcaktojë rikthimin në afat për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit.
 (6) Të njoftojë palët dhe të publikojë vendimin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
 (7) Të urdhërojë që Aktgjykimi të hyjë në fuqi menjëherë.”*

Komentet e Kryeministrit

33. Më 9 mars 2026, Kryeministri dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
34. Fillimisht, Kryeministri thekson se kërkesa e parashtruar nga parashtruesit e kërkesës plotëson kriteret e pranueshmërisë për vlerësim nga Gjykata, përkatësisht në përputhje me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, ndërsa *“Në kuptimin e kërkesës së një akti formal të Kuvendit për të trajtuar çështjen nga Gjykata, referencë i bëhet jurisprudencës së pasur të Gjykatës lidhur me temën në fjalë”* dhe citon Aktgjykimin e Gjykatës KI124/25 (shih, Aktgjykimin në rastin [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 86). Në këtë drejtim Kryeministri shton se: *“[...] sikurse që konstituimi i Kuvendit përbën pikënisje për ushtrimin e pushtetit legjislativ nga ana e Kuvendit të Republikës, zgjedhja e Presidentit nënkupton garancën për ushtrimin kushtetues të institucioneve.”*
35. Përkitazi me meritat e kërkesës, Kryeministri konsideron se: *“[...] me datën 5 mars të vitit 2026, 54 deputetë kishin bojkotuar seancën e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit, duke pamundësuar kuorumin e kërkuar prej 2/3”*. Kryeministri pretendon se deputetët që kanë munguar në seancën e jashtëzakonshme kanë bërë shkelje të dispozitave kushtetuese dhe duke iu referuar Aktgjykimit në rastin KO29/11 thekson se: *“[...] Gjykata e bën të qartë obligimin e deputetëve për të marrë pjesë në seanca dhe në punët e komisioneve të Kuvendit [...]”*.
36. Gjithashtu, Kryeministri duke cituar nenin 40 (Detyrimet) të Ligjit Nr.03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit) se: *“[...] asnjëri nga deputetët që kanë munguar në seancën e datës 5 mars 2026 nuk ka njoftuar me kohë për arsyen objektive të mungesës Kryetaren e Kuvendit; mund të konstatohet lehtësisht që këta 54 deputetë kanë shkelur Kushtetutën dhe si rrjedhojë, kanë provuar të pamundësojnë qëllimshëm zgjedhjen e Presidentit të Republikës.”*
37. Në vazhdim, Kryeministri iu referohet rasteve të Gjykatës, KO124/25 dhe KO72/20 dhe thekson se: *“54 deputetët që kanë munguar në seancën e datës 5 mars 2026, kanë pamundësuar procedurën e filluar për konstituimin e institucionit shtetëror të Presidentit. Veprimi i këtillë buron nga vullneti i popullit e duke qenë qartazi në mospërputhje me Kushtetutën, jurisprudencën e Gjykatës dhe legjislacionin në fuqi lidhur*

me mandatin e deputetit, mund të përkthehet vetëm të provuarit e bllokimit institucional e funksionimit kushtetues të pushteteve në Republikën e Kosovës.” (shih, rastet e Gjykatës [KO124/25](#), parashtrues Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 26 qershorit 2025; dhe [KO72/20](#), parashtrues Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit nr. 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës”, Aktgjykim i 28 majit 2020).

38. Në fund, Kryeministri thekson se: [...] rrjedha e afateve kushtetuese lidhur me zgjedhjen e Presidentit shpie direkt në zgjedhje të jashtëzakonshme, dhe që vazhdimi i sjelljes së këtillë të 54 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës e pamundëson në tërësinë e saj procedurën për zgjedhjen e Presidentit nga Kuvendi i Republikës; gjë e cila pastaj ka pasojë në funksionimin e të gjitha pushteteve dhe shpie tek pasiguria institucionale e juridike në raport me qytetarët e Republikës së Kosovës, është e domosdoshme që Gjykata Kushtetuese të vendos masë të përkohshme deri në përfundimin e trajtimit të rastit në meritum”.

Komentet e PDK-së

39. Më 9 mars 2026, deputetët e PDK-së, të përfaqësuar nga deputeti Përparim Gruda, dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
40. Fillimisht, deputetët e PDK-së parashtrojnë argumentet e tyre përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës. Deputetët e PDK-së duke potencuar paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, konsiderojnë se “[...] parashtruesit nuk kontestojnë një akt juridik konkret të Kuvendit apo të ndonjë institucioni tjetër publik. Përkundrazi, ata kërkojnë që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë sjelljen individuale të disa deputetëve në ushtrimin e mandatit të tyre parlamentar.”
41. Përkitazi, me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se deputetët kanë detyrim kushtetues të marrin pjesë në seancë, deputetët e PDK-së i referohen nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës dhe theksojnë se: “Nga kjo dispozitë rrjedh parimi themelor i mandatit të lirë parlamentar, sipas të cilit deputeti nuk mund të detyrohet juridikisht të veprojë në një mënyrë të caktuar në ushtrimin e funksionit të tij parlamentar.”
42. Në këtë drejtim, deputetët e PDK-së konsiderojnë se “pjesëmarrja në seancë parlamentare apo në një votim është pjesë e ushtrimit të lirë të mandatit parlamentar dhe nuk mund të imponohet përmes një detyrimi kushtetues apo përmes ndërhyrjes së Gjykatës Kushtetuese.”
43. Gjithashtu, deputetët e PDK-së konsiderojnë se deputetët e Kuvendit e ushtrojnë mandatin e tyre në mënyrë të lirë dhe të pavarur dhe duke iu referuar Opinionit të Komisionit të Venecias CDL-AD(2002)012 dhe CDL-AD(2024)040, theksojnë se: “[...] në një demokraci përfaqësuese mandati parlamentar është i lirë dhe nuk mund të imponohet përmes mekanizmave juridikë mënyra e ushtrimit të tij. Rrjedhimisht, pjesëmarrja ose mospjesëmarrja në seanca parlamentare mbetet pjesë e autonomisë së ushtrimit të mandatit politik të deputetit dhe nuk mund të shndërrohet në një detyrim kushtetues të detyrueshëm përmes interpretimit gjyqësor.” (shih, [CDL-AD\(2002\)012](#), Opinion për draft rishikimin e Kushtetutës së Rumanisë, i miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 51-të plenare, më 5–6 korrik 2002; dhe [CDL-AD\(2024\)040](#), Opinion për zbatimin nga

Kuvendi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, i miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën e tij të 141-të plenare, më 6–7 dhjetor 2024).

44. Përkitazi me kërkesën për caktimin e masës së përkohshme, deputetët e PDK-së konsiderojnë se kërkesa është e pabazuar për shkak se: *“[...] është paraqitur më 5 mars 2026, pikërisht në ditën kur ka përfunduar afati kushtetues për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës sipas nenit 86 paragrafi 2 të Kushtetutës. Masa e përkohshme mund të ketë efekt vetëm ndaj një situatë juridike që është ende në zhvillim dhe ndaj një afati që është ende në rrjedhje.”*
45. Në fund, deputetët e PDK-së theksojnë se: *“Së pari, kërkesa nuk konteston një akt juridik konkret të Kuvendit apo të ndonjë institucioni tjetër publik, [...]; Së dyti, pretendimi se deputetët kanë detyrim kushtetues për të marrë pjesë në seancën për zgjedhjen e Presidentit nuk gjen mbështetje në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.[...]; Së treti, kërkesa për vendosjen e një mase të përkohshme për pezullimin e afateve kushtetuese është pa objekt,[...]”*

Përgjigjet e parashtruesve të kërkesës lidhur me komentet e dërguara nga deputetët e PDK-së

46. Më 18 mars 2026, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë përgjigje në komentet e pranuar lidhur me kërkesën KO68/26.
47. Fillimisht, parashtruesit e kërkesës kërkuan paraqitjen e përgjigjeve në komentet e dërguara nga deputetët e PDK-së, pavarësisht asaj se Gjykata nuk u kërkoj atyre dërgimin e komenteve.
48. Përkitazi me komentin e deputetëve të PDK-së se kërkesa e paraqitur nuk është e pranueshme, për shkak se parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë një akt juridik konkret të Kuvendit, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“[...] praktika e Gjykatës Kushtetuese lidhur me interpretimin e juridiksionit të saj e ka vlerësuar seancën konstituive të Kuvendit si akt kushtetues dhe, rrjedhimisht, si çështje kushtetuese që i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës. Në të njëjtën logjikë dhe paralele, edhe seanca për zgjedhjen e Presidentit, e cila ende nuk ka përfunduar, përbën akt kushtetues të përcaktuar në nenin 86 të Kushtetutës dhe si e tillë duhet t'i nënshtrohet interpretimit të Gjykatës Kushtetuese.”*
49. Më tutje, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se: *“[...] nevoja për vendimmarrje dhe interpretim nga Gjykata Kushtetuese bëhet edhe më e domosdoshme nëse merren parasysh interpretimet paraprake të vetë Gjykatës (Aktgjykimi KO29/11 dhe Aktvendimi KO47/16), të cilat kanë krijuar standarde për kuorumin gjatë votimit për zgjedhjen e Presidentit. Megjithatë, këto Aktgjykime nuk e kanë shteruar çështjen e mos-pjesëmarrjes së deputetëve me qëllim të pengimit të kuorumit. [...] Sipas vlerësimit, kërkesat (KO68/26 dhe KO72/26) janë të ndërlidhura ngushtë, pasi të dyja kanë të bëjnë me të njëjtën çështje: zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.”*
50. Parashtruesit e kërkesës, nënvizojnë se: *“Krahas vlerësimit të kushtetutshmërisë së Dekretit Nr.24/2026, është tejet e rëndësishme të trajtohet edhe procedura për zgjedhjen e Presidentit sepse rrethana me moskrijimin e qëllimshëm të kuorumit përmes largimit nga seanca, rrezikon të përsëritet edhe në seancat e ardhshme në legjislaturën e X apo edhe në legjislaturat e ardhshme.”*

51. Më tutje, parashtuesit e kërkesës duke iu referuar rasteve KO97/10, KO57/12 dhe KO79/18, theksojnë se: *“Gjykata Kushtetuese ka interpretuar juridiksionin e saj në mënyrë më të gjerë.”* Po ashtu, parashtuesit e kërkesës vlerësojnë se: *“[...] çështja e zgjedhjes së Presidentit dhe situata e krijuar nga mos-pjesëmarrja e deputetëve në seancë për të pamundësuar kuorumin, ka implikime të drejtpërdrejta në funksionimin e sistemit kushtetues, madje duke cenuar rendin kushtetues, dhe si rrjedhojë plotësohen kriteret e vendosura nga Aktvendimi KO79/18 për të mundësuar interpretimin e kësaj çështjeje.”*(shih, rastet e Gjykatës [KO97/10](#), parashtues Jakup Krasniqi, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010, paragrafët 11 dhe 12; [KO57/12](#), parashtues Presidentja e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 13 korrikut 2012, paragrafi 31; dhe [KO79/18](#), parashtues Presidenti i Republikës së Kosovës, Aktvendim i 21 nëntorit 2018, paragrafi 71.)
52. Më tutje, përkitazi me komentin e deputetëve të PDK-së lidhur me çështjen e detyrimit të deputetëve për të marrë pjesë në procesin e zgjedhjes së Presidentit, parashtuesit e kërkesës konsiderojnë se nuk qëndron dhe theksojnë se: *“[...] i referohemi dispozitave kushtetuese që deputetët janë të obliguar të ushtrojnë mandatin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe të mos pengojnë funksionimin e institucioneve kushtetuese, si dhe aktgjykimeve të cilat e bëjnë të detyrueshme pjesëmarrjen në seanca dhe votim (pro, kundër ose abstenim, [...]).”*
53. Në vazhdim, parashtuesit e kërkesës duke iu referuar rastit KO119/14 konsiderojnë se: *“Edhe tani jemi në situatën ku deputetët duhet të jenë të detyruar që të marrin pjesë në votim, ashtu që të mundësojnë zgjedhjen e Presidentit dhe të mos shkohet drejt shpërndarjes së Kuvendit, kur tanimë ekziston një shumicë parlamentare funksionale, përndryshe do të minohej thelbi i demokracisë parlamentare.”*
54. Tutje, parashtuesit e kërkesës i referohen Raportit të Komitetit për Çështje Politike dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me titull *“Marrëdhënia në mes të mazhorancës parlamentare dhe opozitës në demokraci”* dhe përmbledhjes së opinionëve të Komisionit të Venecias duke theksuar se: *“Nga këto konstatime të paraqitura më lartë, është më se evidente që veprimet e opozitës duke paralajmërua bojkotimin e seancës për zgjedhjen e Presidentit, duke mos u angazhuar në diskutime konstruktive, duke mos nominuar asnjë kandidat për pozitën e Presidentit, dhe në fund duke bojkotuar seancën në fjalë, shkojnë në kundërshtim me këto parime të përcaktuara.”*
55. Po ashtu, parashtuesit e kërkesës duke cituar pjesë nga Rezoluta për Armeninë të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, konsiderojnë se: *“Nëse tërheqim një paralele me bojkotin që po organizohet në Kosovë për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës, assesi nuk ekzistojnë rrethana as të rralla e as ekstreme të funksionimit të Kuvendit, që do të vinin në pikëpyetje pjesëmarrjen e opozitës. Kuvendi i Kosovës ka legjitimitet të plotë, i dalur nga zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, pas zgjidhjeve të lira dhe demokratike të mbajtura.”*
56. Përkitazi me referimet e deputetëve të PDK-së në dy opinionet e Komisionit të Venecias, [CDL-AD\(2002\)012](#) dhe [CDL-AD\(2024\)040](#), parashtuesit e kërkesës theksojnë se janë interpretuar në mënyrë të gabuar. Përkatësisht, lidhur me opinionin e parë, parashtuesit e kërkesës theksojnë se: *“[...] nga konstatimet e Komisionit të Venecias në këtë Opinion, është më se e qartë se fushëveprimi i Opinionit kishte të bënte me proporcionalitetin e humbjes së mandatit si një masë për mos pjesëmarrje në punimet e Kuvendit dhe sugjerimit për sanksione më të buta, dhe jo me kërkesat për krijimin e kuorumeve që janë esenciale për funksionimin kushtetues të institucioneve, dhe evitimin e pasojave siç janë*

zgjedhjet e parakohshme, për çka bazohet Kërkesa jonë në rastin KO nr. 68/26.” Ndërsa përkitazi me opinionin e dytë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “[...] nëse lexohet me kujdes dhe në tërësi ky Opinion si dhe të gjitha opinionet tjera përkatëse dhe standardet e Këshillit të Evropës në këtë drejtim, çështjen e mandatit të lirë ato e përkufizojnë që mandati i deputetëve nuk është i lidhur me partinë politike me të cilën kanë garuar si deputet, dhe ata kanë të drejtën të largohen dhe ndryshojnë grupin parlamentar, si dhe të mos votojnë në linjë me partinë e tyre.”

57. Tutje, përkitazi me komentin e deputetëve të PDK-së lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, parashtruesit e kërkesës theksojnë: “[...] çështja e afatit për zgjedhjen e Presidentit është aktualisht objekt shqyrtimi në rastin KO72/26, ku kontestohet kushtetutshmëria e dekretit të Presidentes së Kosovës. Po ashtu, kërkesa KO68/26 është parashtruar me 5 mars 2026, pikërisht ditën kur është mbajtur seanca për zgjedhjen e Presidentit.”
58. Në fund, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “Ne i kundërshtojmë fuqishëm këto pretendime dhe propozime, bazuar në arsyetimet e paraqitura më lartë, ku jemi mbështetur në argumente të bazuara në Kushtetutë, praktika e konsoliduar kushtetuese dhe standardet e praktikave të mira evropiane. Si rrjedhojë, mbetemi plotësisht pranë kërkesës tonë në rastin KO68/26, me pritjen që Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim të drejtë dhe sqarues mbi procedurën e zgjedhjes së Presidentit, në mënyrë që të shmanget kriza e panevojshme politike e krijuar tashmë dhe të sigurohet stabiliteti institucional dhe kushtetues për të ardhmen e vendit.”

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 21

[Parimet e Përgjithshme]

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.

[...].”

Neni 65

[Kompetencat e Kuvendit]

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;

[...]

(7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;

[...].”

Neni 70

[Mandati i Deputetëve]

*“1. Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.
[...].”*

Neni 74
[Ushtrimi i Funksionit]

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”

Neni 82
[Shpërndarja e Kuvendit]

1. Kuvendi shpërndahet në këto raste:

- (1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;*
- (2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;*
- (3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.
[...].”*

Neni 86
[Zgjedhja e Presidentit]

- “1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.*
- 2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.*
- 3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidat për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për President të Republikës së Kosovës.*
- 4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.*
- 6. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.*

Neni 116
[Efekti Juridik i Vendimeve]

- “1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*
- 2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i*

Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.

4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallet në Gazetën Zyrtare.”

RREGULLORE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 22 (Përgjegjësitë e deputetit)

“1. Deputeti e ushtron mandatin në përputhje me Kushtetutën dhe u shërben interesave të Republikës së Kosovës.

*2. Deputeti ka për detyrë dhe obligim që të marrë pjesë në punimet e Kuvendit.
[...]*”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

59. Në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*

60. Gjykata vëren se parashtresit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”

61. Përveç kriterëve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashttrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42 (Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 [5] të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”

62. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72

(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit.

(2) [...]

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

63. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

“(1) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur Gjykata përcakton se pretendimi:

(a) nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm; ose

(b) nuk përfaqëson një kontest.

(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

[...]

(b) kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata; [...]

64. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës.

65. Gjykata, fillimisht rikujton që më 9 shkurt 2025, u mbajtën zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Më 15 prill 2025, filloi Seanca Konstituive për konstituimin e Kuvendit, i cili u konstituua pas nxjerrjes së tri (3) Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese [KO124/25, KO193/25 dhe KO196/25 dhe KO265/25]. Si rezultat i dështimit për zgjedhjen e Qeverisë nga Kuvendi, në seancën e 19 nëntorit 2025 dhe Dekretin e Presidentit [Nr. 209/2025] për Shpërndarjen e Legjislaturës së IX-të, Presidentja përmes Dekretit [nr. 210/2025] të 20 nëntorit 2025 caktoi dhe shpalli zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që u caktuan të mbahen më 28 dhjetor 2025. Gjykata rikujton se si rezultat i certifikimit të zgjedhjeve të 28 dhjetorit 2025, më 11 shkurt 2026 u mbajt Seanca Konstituive e Kuvendit, me ç'rast përmes zgjedhjes së Kryetares së Kuvendit dhe nënkryetarëve, Legjislatura e X-të e Kuvendit u shpall e konstituuar. Po të njëjtën ditë,

Kuvendi bazuar në përcaktimet kushtetuese, përkatësisht nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës vijoi me zgjedhjen e Qeverisë. Në vijim, duke marrë për bazë përcaktimet e nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës dhe faktit që Presidentes aktuale i përfundon mandati më 4 prill 2026, Kuvendi, më 5 mars 2026 bazuar në kërkesën e dyzet e dy (42) deputetëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mbajti seancën e jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës “Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës”. Në këtë seancë të jashtëzakonshme për zgjedhjen e Presidentit, të thirrur nga Kryetarja e Kuvendit u propozuan dy (2) kandidatë për President. Pasi që u konstatua se në sallë ishin prezent gjashtëdhjetë e gjashtë (66) deputetë, si rezultat i mungesës së prezencës së 2/3 të deputetëve, Kryetarja e Kuvendit ndërpreu seancën e jashtëzakonshme. Në vijim, më 6 mars 2026, Presidentja, nxori Dekretin [nr.24/26] sipas të cilit specifikohet se: “Shpërndalet Legjislatura e Dhjetë (X) të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, si rezultat i kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës. (shih, rastin e Gjykatës në kërkesat e bashkuara, [KO72/26 dhe KO74/26](#), parashtrues KO72/26, Qeveria e Republikës së Kosovës; dhe KO74/26, Arbërie Nagavci dhe 30 (tridhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit [nr.24/2026] të 6 marsit 2026 të Presidentes së Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 25 marsit 2026, paragrafi 111).

66. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë “procedurën për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës” dhe kërkojnë “vendosjen e masës së përkohshme për të pezulluar afatet kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit”.
67. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se veprimet e një grupi të deputetëve, të cilët nuk kanë marrë pjesë në seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit, të 5 marsit 2026, janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe detyrimet e tjera ligjore duke theksuar se: “Këtë konstatim e bazojmë në faktin se 54 deputetë nuk kanë marrë pjesë, me qëllim për të pamundësuar kuorumin prej 80 deputetëve të nevojshëm në dy raundet e para të zgjedhjes së Presidentit.” Tutje, parashtruesit e kërkesës i referohen paragrafit 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] dhe theksojnë se ky nen “[...] kërkon që zgjedhja të behet jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit, andaj kjo është një obligim procedural kushtetues dhe deputetët e caktuar nuk mund të pengojnë këtë procedurë përmes sabotageve të qëllimshme që shkaktojnë duke refuzuar të marrin pjesë në seancën e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit.” Gjykata, po ashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se paragrafi 2 i nenit 22 (Përgjegjësitë e deputetit) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës përcakton se deputetët janë të obliguar të marrin pjesë në punimet e Kuvendit dhe theksojnë se mospjesëmarrja e deputetëve në seancën e jashtëzakonshme dhe në votimin për zgjedhjen e Presidentit është në kundërshtim me Kushtetutën dhe detyrat dhe me Aktgjykimin e Gjykatës KO29/11. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës i referohen rastit [KO47/16](#), duke theksuar se në këtë rast “Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se prania e 120 deputetëve nuk është kusht për vlefshmërinë e zgjedhjes së Presidentit, mirëpo në fokus e ka pasur vetëm kuorumin prej 80 dhe 61 deputetësh [...]”. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata “Të përcaktojë rikthimin në afat për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit.” (shih, rastet e Gjykatës [KO29/11](#), parashtrues Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011”, Aktgjykim i 28 marsit 2011; dhe [KO47/16](#), parashtrues Aida Derguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë

së “Vendimit nr, 05-V-233, të 26 shkurtit 2016, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës”, Aktgjykim i 21 marsit 2016)

68. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës kundër argumentohen nga deputetët e PDK-së, të cilët konsiderojnë se (i) parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë akt juridik konkret të Kuvendit; (ii) parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësim të sjelljes individuale të disa deputetëve; (iii) pjesëmarrja ose mospjesëmarrja në seanca parlamentare mbetet pjesë e autonomisë së ushtrimit të mandatit politik të deputetit dhe nuk mund të shndërrohet në një detyrim kushtetues; dhe se (iv) kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme për pezullimin e afateve kushtetuese është pa objekt.
69. Duke marrë për bazë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, si dhe argumentet dhe kundër argumentet e palëve të interesuara, Gjykata konsideron se objekt i vlerësimit të kësaj kërkesë përbën (i) procedura për zgjedhjen e Presidentit; dhe (ii) kërkesa për kthim të afateve “për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit.”
70. Fillimisht, përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidhet me procedurën për “zgjedhjen e Presidentit”, Gjykata vë në pah parimet e përgjithshme për procedurën e zgjedhjes së Presidentit, të cilat burojnë nga Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe praktika gjyqësore e saj, dhe të cilat janë shtjelluara në mënyrë të detajuar edhe në rastet KO47/16 dhe KO29/11. Në këtë drejtim, nga këto parime rezulton se:
- (i) Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 86 të Kushtetutës;
- (ii) zgjedhja e Presidentit zhvillohet në 3 (tri) raunde të votimit, ku në 2 (dy) raundet e para kërkohen votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, ndërsa në raundin e tretë kërkohet shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit;
- (iii) Në mënyrë që 2 (dy) raundet e para të jenë të vlefshme në procedurën për zgjedhjen e Presidentit, kërkohet që të paktën 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve të jenë të pranishëm dhe të votojnë. Ndërsa për raundin e 3-të (tretë) kërkohet të paktën prania dhe votimi i shumicës të të gjithë deputetëve; dhe
- (iv) votimi për zgjedhjen e Presidentit zhvillohet me votim të fshehtë.
71. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se, përkitazi me procedurën e zgjedhjes së Presidentit, ajo tashmë ka konsoliduar praktikën e saj gjyqësore në këtë kontekst, respektivisht në rastet KO47/16 dhe KO29/11, dhe në rrethanat e rastit aktual, Gjykata konsideron se nuk paraqiten rrethana të reja që do të arsyetonin një rishqyrtim të mëtejshëm të kësaj çështjeje. Rrjedhimisht, Gjykata bazuar në pikën (b) të paragrafit 2 të rregullit 54 të Rregullores së punës konstaton se kjo çështje përbën çështje të gjykuar (*res judicata*) dhe, si e tillë, hyn në kategorinë e kërkesave që përfaqësojnë përsëritje të një kërkesë të mëparshme të shqyrtuar dhe të vendosur nga Gjykata.
72. Tutje, përkitazi me vlerësimin për kthimin e afateve “për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit.” Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të saj, sipas së cilës kur vlerëson se a aplikohet nën paragrafët (a) dhe (b) të paragrafit 1 të rregullit 54 të Rregullores së punës, për çështjen e rasteve para saj, ajo duhet t'u përgjigjet dy pyetjeve si në vijim: së pari, se a qëndrojnë ende rrethanat për të cilat ishin ankuar drejtpërdrejtë parashtruesit e kërkesës; dhe, së dyti, nëse efekti i shkeljes eventuale të Kushtetutës për shkak të atyre rrethanave

gjithashtu është korrigjuar (shih, rastin e Gjykatës: [KO98/20](#), *parashtrues Hajrulla Çeko dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr.52/2020, të Presidentit të Republikës së Kosovës i datës 14 mars 2020).

73. Në rastin konkret, në kontekst të aplikimit të pikës së parë të testit të lartcekur, përkatësisht të vlerësuarit “*nëse ende qëndrojnë rrethanat për të cilat ishin ankuar drejtpërdrejtë parashtruesit e kërkesës*”, Gjykata nënvizon se kjo përfshin para së gjithash vërtetimin e situatës nëse “*Kalimi i afateve kushtetuese mund të çojë në shpërndarjen e Kuvendit dhe mbajtjen e zgjedhjeve të treta brenda rreth 18 muajve*”.
74. Në ndërlidhje me këtë pikë, Gjykata rikujton se më 9 mars 2026 ka regjistruar një kërkesë të dorëzuar nga Qeveria, përmes së cilës kërkoj vlerësimin e kushtetutshmërisë së Dekretit [nr. 24/2026], të 6 marsit 2026, të Presidentes së Republikës së Kosovës për shpërndarjen e Legjislaturës së Dhjetë (X) të Kuvendit. Lidhur me këtë, Gjykata përmes Vendimit për Vendosjen e Masës së Përkohshme në rastin KO72/26, më 9 mars 2026 vendosi që “(i) të caktojë ex officio dhe sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës masën e përkohshme me të cilën ndalohet çdo veprim i Presidentes së Republikës Kosovës në lidhje me Dekretin [nr. 24/2026] të 6 marsit 2026, si dhe të ndalojë çdo veprim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kohëzgjatjen e përcaktuar sipas pikës II të këtij Vendimi; (ii) të urdhërojë që masa e përkohshme hyn në fuqi më 9 mars 2026, në kohëzgjatje deri më 31 mars 2026; (iii) t’ua kumtojë këtë Vendim palëve; (iv) të publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe që (v) Vendimi hyn në fuqi më 9 mars 2026.”
75. Prandaj për sa i përket pikës së parë të vlerësimit, nuk është më kontestues fakti i “*kalimit të afateve kushtetuese*”, për shkak se përmes Aktgjykimit në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26, cituar më lartë, Gjykata thekson se kjo pikë përfshin vlerësimin kushtetues, i cili ishte objekt shqyrtimi në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26 (shih, rastin e Gjykatës KO72/26 dhe KO74/26, cituar më lart).
76. Gjykata në vijim konkludon se në rastin konkret lidhur me çështjen e afateve kushtetuese, kjo çështje është trajtuar dhe vendosur përmes Aktgjykimit në kërkesave të bashkuara KO72/26 dhe KO74/26, cituar më lart.
77. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se nuk ka çështje për shqyrtim, ngase kjo tashmë është sqaruar qartë edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës përmes rasteve KO29/11 dhe KO47/16, cituar më lart (shih, në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës: [KO98/20](#), *parashtrues Hajrulla Çeko dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr.52/2020, të Presidentit të Republikës së Kosovës i datës 14 mars 2020, Vendim për heqje të kërkesës nga lista i 18 nëntorit 2020, paragrafi 83; dhe [KO63/12](#), me parashtrues *Alma Lama dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, Vendim për heqje të kërkesës nga lista i 10 dhjetorit 2012, paragrafi 19).
78. Pra, si parim i përgjithshëm procedural, Gjykata nuk nxjerrë vendime për raste ku çështja më nuk përfaqëson kontest, apo pretendimi nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm. (shih, rastet e Gjykatës, KO98/20, cituar më lart, paragrafi 84; dhe KO63/12, cituar më lart, paragrafi 23).

79. Prandaj, duke i konsideruar vlerësimet e lartcekura, Gjykata tashmë konstatoi se 2 (dy) kushtet e aplikimit nënparagrafit (a) të paragrafit 1 të rregullit 54 të Rregullores së punës janë përmbushur. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesve të kërkesës për vlerësimin e kthimit të afateve “*për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit*”, nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm.

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

80. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata që të nxjerrë vendim për caktimin e masës së përkohshme “*ndaj procedurës dhe afateve kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, pasi ekziston rreziku i dëmeve të pariparueshme për demokracinë dhe stabilitetin institucional në Kosovë.*”
81. Në këtë kontekst, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka vendosur për hedhje poshtë të kërkesës dhe rrjedhimisht konsideron se nuk është i nevojshëm shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 48 (1) (d) dhe 54 (1) (a) (2) (b) të Rregullores së punës, më 30 mars 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TË HEDHË POSHTË kërkesën e parashtruesve të kërkesës;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË që ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljatifi

Nexhmi Rexhepi